

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

21 korrik 2009
Prishtinë
Ap-Kz Nr. 481/2008

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë nga Gjyqtari Ndërkombëtar Emilio Gatti, si Kryetar i Kolegjit, Gjyqtarët Ndërkombëtar Maria Giuliana Civinini dhe Guy Van Craen, dhe Gjyqtarët Kosovar Vendor Salih Mekaj dhe Avdi Dinaj, si anëtarë të kolegjit,


në procedurën penale kundër:

Osman ZYBERAJT, i biri i Sefer dhe Alemshahe Hotit, i lindur më 6 prill 1963 në fshatin Drenovc, Komuna e Rahovecit, shqiptar kosovar, me vendbanim në Prizren, rruga Jeta E Re, i martuar dhe ka tre fëmijë, afarist me profesion, ka të mbaruar shkollën e mesme, momentalisht në paraburgim në burgun e Dubravës; dhe

Shyqeri SHALËS, i biri i Shaqir dhe Naxhije Hotit, i lindur më 24 tetor 1968 në Rogovë, Komuna e Gjakovës, shqiptar kosovar, i martuar dhe ka gjashtë fëmijë, me vendbanim në fshatin Rogovë, tregtar, me gjendje ekonomike mesatare, ka mbaruar shkollën e mesme, momentalisht në paraburgim në qendrën e paraburgimit në Dubravë.

Duke vendosur mbi ankesat kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarku në Prizren, P.nr. 155/2007, të datës 17 prill 2008, i cili i ka dënuar të pandehurit për kryerjen e veprave penale 1) vrasje e rëndë në bashkëkryerje, në kundërshtim të nenit 147 paragrafit 5 dhe nenit 23 të KPPK-së, 2) vrasje në tentativë në bashkëkryerje, në kundërshtim të nenit 147 paragrafi 11 dhe nenet 20 dhe 23 të KPPK-së, 3) Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim të nenit 328 paragrafit 1 të KPPK-së, në fshatin Xërxë, Komuna e Prizrenit, më 10 tetor 2005, dhe Osman Zyberajn vetëm për kryerjen e veprës penale 4) mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim të nenit 328 paragrafit 2 të KPPK-së pas arrestimit të tij më 19 prill 2007, ankesat të cilat janë paraqitur nga avokatët mbrojtës në emër të Osman Zyberajt më 4 gusht 2008 dhe në emër të Shyqeri Shalës më 11 gusht 2008.

Pas leximit të kërkesës së Osman ZYBERAJT, të datës 25 tetor 2008, e bashkangjitur në ankesën e avokatit të tij mbrojtës, pas dëgjimit të parashtrësave të avokatëve mbrojtës Z. Ruzhdi GASHIT, Z. Ethem RUGOVËS, Z. Fatmir CELINËS, Z. Rexhëp HASANIT dhe Z. Hazer SUSURIT, dhe parashtrësat e Z. Osman ZYBERAJT dhe Z. Shyqeri SHALËS, dhe mendimit dhe propozimit të ZPSK-së Prokurores Znj. Annette Milk, në seancën e mbajtur më 21 korrik 2009,



duke vepruar sipas nenit 420 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së) lëshon këtë

AKTGJYKIM

PRANOHET pjesërisht ankesa e paraqitur më 4 gusht 2008, në dobi të Osman ZYBERAJT, 1) sa i përket kualifikimit ligjor të Pikës 1 dhe Pikës 2, të cilat janë unifikuar dhe kualifikuar si Vrasje e Rëndë në kundërshtim të nenit 147 pika 11 të KPPK-së, të kryer në Bashkëkryerje sipas nenit 23 të KPPK-së, në këtë, ai me një person tjetër më 10 tetor 2005 në fshatin Xërxë, Komuna e Prizrenit kanë vrarë Hasan Rustemin dhe kanë tentuar ta vrasin Nazim Rustemin, dhe 2) sa i përket kualifikimit ligjor të Pikës 3, Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të Armëve, në kundërshtim të nenin 328 paragrafit 2 të KPPK-së, në këtë, më 10 tetor 2005 në fshatin Xërxë, Komuna e Prizrenit ai ka qenë në posedim të armës. REFUZHET në pjesën tjetër, ankesa e paraqitur më 4 gusht 2008 në dobi të Osman ZYBERAJT.


PRANOHET ankesa e paraqitur më 11 gusht 2008, në dobi të Shyqeri SHALËS dhe i pandehuri LIROHET nga të gjitha akuzat.

Në pajtueshmëri me nenin 391.5 të KPPK-së, koha e kaluar në paraburgim nga Osman ZYBERAJ është përfshirë në kohëzgjatjen e dënimit.

Vërtetohet në pjesën tjetër Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren, P. Nr. 155/2007, i datës 17 prill 2008.

Shpenzimet e procedurave të shkallës së dytë mbesin në përgjegjësi të Osman ZYBERAJT.

Lidhur me paraburgimin e secilit të pandehur vendoset me aktvendim të veçantë sipas neneve 426 dhe 393 të KPPK-së.



ARSYETIMI

Historia e Procedurës

1. Më 17 korrik 2007, Prokurori Publik Ndërkombëtar ka ngritur aktakuzën kundër Osman ZYBERAJT dhe Shyqeri SHALËS duke i akuzuar dy të pandehurit për veprat penale 1) vrasje të rëndë në bashkëkryerje në kundërshtim të nenit 147 paragrafët 4, 5 dhe 8 dhe nenit 23 të KPPK-së, 2) vrasje në tentativë në bashkëkryerje, në kundërshtim të nenit 147 paragrafi 11 dhe nenet 20 dhe 23 të KPPK-së, 3) Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim të nenit 328 paragrafët 1 dhe 2 të KPPK-së, në fshatin Xërxë, Komuna e Prizrenit, më 10 tetor 2005, dhe Osman Zyberajn vetëm për kryerjen e veprës penale 4) mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim të nenit 328 paragrafët 1 dhe 2 të KPPK-së pas arrestimit të tij më 19 prill 2007.

Pohimet kundër dy të pandehurve kanë qenë të lidhura me vrasjen e rëndë të Hasan Rustemit, vrasjen e rëndë në tentativë të Nezim Rustemit dhe me mbajtjen në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve më 10 tetor në Xërxë dhe kundër Osman Zyberajn vetëm për mbajtjen në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve më 19 prill 2007.

Gjyqtari për konfirmimin e aktakuzës më 30 gusht 2007 ka konfirmuar aktakuzën në tërësi.

2. Shqyrtimi kryesor publik kundër Osman Zyberajt dhe Shyqeri Shalës është mbajtur në Gjykatën e Qarkut në Prizren dhe/ose në objektin e paraburgimit në Dubravë dhe ka zgjatur prej 31 janarit 2008 deri më 17 prill 2008.

Në seancën dëgjimore të 19 prillit 2008 është shpallur aktgjykimi.

Dy të pandehurit Osman Zyberaj dhe Shyqeri Shala janë shpallur fajtor për të gjitha veprat penale për të cilat ishin akuzuar dhe secili është dënuar me dënim unik prej njëzet e pesë (25) vite burgim.

3. Osman Zyberaj ishte arrestuar më 19 prill 2007, kurse Shyqeri Shala më 23 maj 2007, dhe prej atëherë janë mbajtur në paraburgim.

4. Avokatët mbrojtës e të dy të pandehurve kanë paraqitur ankesë kundër aktgjykimit si në vazhdim. Ankesa e Z. Ruzhdi Gashit dhe Z. Ethem Rugovës nga Prizreni, avokatët mbrojtës të të pandehurit Osman Zyberaj ishte paraqitur më 4 gusht 2008.

Më 29 tetor 2008 avokati mbrojtës Ethem Rugova i ka dorëzuar Gjykatës një letër nga Osman Zyberaj e cila duhej ti bashkëngjitej ankesës.

Ankesa e Z. Rexhep Hasanit nga Prizreni si avokat mbrojtës i të pandehurit Shyqeri Shalës ishte paraqitur më 11 gusht 2008.

5. Pas dorëzimit të lëndës te Gjyqtarët e EULEX-it në janar 2009, Gjykata Supreme e Kosovës më 21 korrik 2009 ka caktuar një seancë ankimore ku pas raportit të Gjyqtarit

raportues, të pandehurit dhe avokatët e tyre mbrojtës i kanë sqaruar ankesat e tyre dhe Prokurori Ndërkombëtar i është përgjigjur siç është cekur në procesverbal.

6. Gjykata ka mbajtur këshillimin më 21 korrik 2009.

Gjetjet e Gjykatës Ex Officio

I

Paraprakisht katër çështje duhet të merren parasysh.

7. Ankesa në emër të Osman Zyberajt ishte paraqitur më 4 gusht 2008.

Siç do të shihet më tutje, ankesa ka kërkuar pafajësinë e të pandehurit nga pikat 1, 2 dhe 3.

Gjatë shqyrtimit kryesor i pandehuri asnjëherë nuk është deklaruar fajtor.

Më 29 tetor 2008 avokati mbrojtës i Osman Zyberajt i ka dorëzuar kësaj Gjykate një letër të datës 25 tetor 2008 nga i pandehuri për t'iu bashkangjitur ankesës së tij.

Në këtë letër i pandehuri, pasi që ka kërkuar rigjykim, ai ka shtuar që “e pranon që e kishte vrarë Hasan Rustemin (Shef i Shërbimit të Inteligjencës) dhe që e ka plagosur vëllanë e tij”.

Gjatë seancës pranë kësaj Gjykate Zyberaj ka deklaruar: “është e vërtetë që më 10 tetor 2005 ka ndodh një vrasje dhe ajo është kryer nga unë. Përveç që e kam paraqitur me shkrim kam dashur ta them edhe gojarisht”.

Zyberaj nuk ka dhënë detaje lidhur me faktet.


Gjykata është e mendimit që kërkesa me shkrim dhe deklarata me gojë e Osman Zyberajt paraqet një lloj të deklaratës së fajësisë dhe jo një dëshmi të re, e cila mund të merret vetëm gjatë dëgjimit e jo gjatë seancës (neni 412.1 i KPPPK-së).

I pandehuri thjeshtë ka pranuar që kishte kryer vrasjen e Hasan Rustemit dhe vrasjen në tentativë të vëllait të tij Nezim, pa hyrë në detaje lidhur me faktet apo shpalljen e mbrojtjes së tij.

Për më tepër, deklarata e Osman Zyberajt nuk e ndryshon gjendjen faktike siç është përcaktuar nga Gjyqtari i parë.

8. Një çështje tjetër është ngritur nga avokati mbrojtës i Shyqeri Shalës gjatë seancës para kësaj gjykate dhe ka të bëjë me përjashtimin e mundshëm të Prokurorit publik të shqyrtimit gjyqësor Z. Robert Dean, për shkak të aktivitetit në të njëjtën kohë si Drejtor i Departamentit të Drejtësisë (DD) të UNMIK-ut dhe si prokurorë.

Avokati mbrojtës bazon kërkesën e tij në nenin 4.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/2 sipas së cilës:” Gjyqtari ose prokurori ndërkombëtar nuk mund të mbajë post tjetër publik apo administrativ i cili nuk pajtohet me funksionin e tij/saj dhe të angazhohet në ndonjë detyrë tjetër të natyrës profesionale qoftë me pagesë qoftë pa pagesë, apo të angazhohet në ndonjë aktivitet tjetër jokompatibil me funksionin e tij/saj”.



Avokati mbrojtës kërkon, sipas nenit 40 paragrafit 3 lidhur me nenin 45 paragrafin 1 të KPPPK-së, që autonomia dhe pavarësia e prokurorit Z. Robert Dean mund të vihet në dyshim për shkak të aktivitetit administrativ të Z. Dean si Drejtor i DD-së.

Kjo Gjykatë refuzon këtë kërkesë sepse nga njëra anë nuk ka asnjë dyshim që Z. Robert Dean ka qenë “prokuror i autorizuar” i aftë për ta ngritur aktakuzën kundër dy të pandehurve (shih nenin 6 dhe 304 të KPPPK-së).

Nga ana tjetër kjo kërkesë për diskualifikim është ngritur nga avokati mbrojtës pas skadimit të afatit të përcaktuar me nenin 41 paragrafin 2 të KPPPK-së, që është fillimi i shqyrtimit gjyqësor.

Aktiviteti i Z. Dean si Drejtor i DD-së së UNMIK-ut ka qenë i ditur publikisht para fillimit të shqyrtimit gjyqësor dhe ky afat është dashur të respektohet nga personi i cili ka dashur ta paraqes një kërkesë të tillë.

9. Tri pikat duhet të ekzaminohen ex officio sipas nenit 415 paragrafit 1 pikës 4 të KPPPK-së sepse janë të lidhura me shkeljen e ligjit penal të bëra nga Gjykata e Shkallës së Parë në dëm të të akuzuarit.

Dy pikat e para janë të lidhura me rrethanat rënduese të parapara me nenin 147 pikat 5 dhe 11 të KPPK-së, e treta është e lidhur me kualifikimin ligjor të faktit me të cilën merret Pika 3.

10. Siç është parë më lart, gjyqtari i parë i ka dënuar të dy Osman Zyberajn dhe Shyqeri Shalën për veprën penale vrasje e rëndë sipas nenit 147 pikës 5 të KPPK-së, vrasja e Hasan Rustemit është kryer në atë mënyrë që tregon “shpërfillje të pamëshirshme ndaj jetës dhe në mënyrë të dhunshme”.

Të dy ankesat pohojnë që aktgjykimi i ankimuar nuk ka dhënë asnjë arsye apo vërtetim me ndonjë fakt se pse aktet e akuzuara janë kryer mizorisht dhe dhunshëm.

Gjyqtari i parë ka ekzaminuar (faqet 22 – 23 dhe 26) të rrethanave rënduese të parapara me nenin 147 nr. 5 të KPPK-së, duke konstatuar që sjellja e të pandehurit ka përbërë “një sulm të dhunshëm mbi strukturën e marrëdhënieve etnike në Kosovë me qëllim të frikësimit të tjerëve, ngjashëm me terrorizmin dhe përdorimin e dhunës për frikësim”.

Hapja e zjarrit ndaj dy personave në pikë të ditës në një vend publik dhe vrasjes së pamëshirshme është “shpërfillje e qartë e pamëshirshme ndaj jetës së viktimave dhe dëmi i shkaktuar ndaj të tjerëve, përfshirë komunitetin në tërësi”.


Kjo Gjykatë nuk e ndanë mendimin e njëjtë me Gjyqtarin e parë.

Rrethanat rënduese të parapara me nenin 147 pikën 5 të KPPK-së janë të lidhura në mënyrë strikte me aktin e vrasjes dhe modalitetet e saj.

Arsyet, qëllimet, rezultatet e vrasjes nuk kanë asgjë të bëjnë më këto rrethana rënduese nëse nuk janë të shoqëruara me modalitete specifike mizorie dhe të dhunshme.

Duhet të kemi parasysh që çdo vrasje përmban një minimum të dhunës dhe mizorisë.

Për këtë arsye rrethanat rënduese të ngarkuara mund të integrohen vetëm nëse shkalla e mizorisë dhe dhunës e tejkalon këtë “minimum” dhe arrin në intensitetin e dukshëm.



Pamëshira është karakteristikë e një akti të kryer pa mëshirë apo keqardhje ndaj viktimës. Ndodh në rastet kur kryerësi jo vetëm që e vret viktimën mirëpo qëllimisht i shkakton atij dhimbje dhe vuajtje të panevojshme.

Në këtë rast brutaliteti dhe vrazhdësia e tejkalojnë vrasjen dhe tregon një shkallë më të lartë të përgjegjësisë së tij penale.

Vetëm në këtë rast ka një arsyetim për rrethanat rënduese, e cili e dallon këtë krim nga vrasja jo e rëndë siç parashihet me nenin 146 të KPPK-së.

Duhet të merret parasysh mënyra analoge e dhunës së paraparë me nenin 147 pikën 5: kjo dhunë duhet ta tejkaloj minimumin e domosdoshëm për vrasjen jo të rëndë dhe të tregoj një shkallë më të lartë të përgjegjësisë penale.

Në këtë rast kryerësit kanë vepruar brenda disa sekondave, duke përdorur armë vdekjeprurëse si revolva apo pushka automatike, tre plumba kanë kaluar nëpër gjoksën e Hasan Rustemit, njëri e ka shpuar zemrën e tij, ai është vrarë menjëherë (shih raportin e autopsisë) aty nuk ka pasur kohë për zemërim ndaj viktimës.

E njëjta gjithashtu vlen për viktimën e dytë, Nazim Rustemin, i cili ishte plagosur njëjtë brenda disa sekondave dhe ka mbijetuar sepse kryerësit kanë ikur.

Në këtë rast nuk ka baza për rrethanat rënduese të parapara me nenin 147 pikën 5, sepse përdorimi i mizorisë dhe dhunës nuk e ka tejkalar nevojën për vrasje.

Atëherë kjo rrethanë rënduese duhet të përjashtohet.

11. Sa i përket rrethanave rënduese të përcaktuara me nenin 147 pikën 11 të KPPK-së mund të vërehet si në vijim.

Gjyqtari i parë i ka dënuar dy të pandehurit për dy akuza të ndryshme: njëra vrasje e rëndë (akuza 1) dhe tjetra vrasje e rëndë në tentativë (akuza 2) dhe vetëm të dytën e ka konsideruar si të rëndë sipas nenit 147 pika 11.


Dënimi për dy akuza të ndryshme e shkel ligjin penal në dëm të të akuzuarit sepse sipas dispozitave të nenit 147 pika 11, këto dy fakte nuk mund të mbahen të ndara por duhet të konsiderohen si një vepër penale unike.

Pasi që kryerja (apo tentimi për të kryer, sipas nenit 20 të KPPK-së) i më shumë se një vrasjeje të qëllimshme është qartazi objekt i rrethanës rënduese, kur gjyqtari është në prezencë të të dy vrasësve, ai duhet ta zbatojë këtë rrethanë dhe mund të dënoj vetëm për një vepër penale e jo për dy.

Rrethana rënduese mund të zbatohet në këtë rast edhe pse vetëm një person është vrarë, sepse lidhur me viktimën e dytë janë zbatuar dispozitat e nenit 20 të KPPK-së për tentim të kryerjes së krimit.

Zbatimi i kësaj rrethane rënduese e bënë prandaj të domosdoshëm bashkimin e dy krimeve të vrasjes dhe vrasjes në tentativë në një akuzë të unifikuar, përshkrimi faktit i së cilës mbetet i njëjtë siç është përcaktuar në aktgjykimin e shkallës së parë dhe kualifikimi ligjor i së cilës është Vrasje e Rëndë, në kundërshtim të nenit 147 pikës 11 të KPPK-së, të kryer në Bashkëkryerje sipas nenit 23 të KPPK-së, dhe në këtë, më 10 tetor 2005 në fshatin Xërxë, Komuna e Prizrenit, i pandehuri me një person tjetër kanë vrarë Hasan Rustemin dhe kanë tentuar të vrasin Nazim Rustemin.

12. Sa i përket Pikës 3 duhet vërejtur se gjyqtari i parë e ka kualifikuar atë në mënyrë të gabuar dhe në dëm të të akuzuarit në shkellje të nenin 328 paragrafit 1 të KPPK-së, kurse kualifikimi ligjor i duhur i saj është sipas nenit 328 paragrafit 2 të KPPK-së.



Arsyet në këtë rast janë që, përdorimi i armëve në mënyrë kërcënuese, frikësuese apo në mënyrë tjetër të paautorizuar tanimë ishte përfshirë në krim të vrasjes së rëndë.

Çfarë mbetet është pronësia, kontrolli dhe posedimi i armës pa Leje valide për mbajtjen e autorizuar të armës sipas nenit 328 paragrafit 2 të KPPK-së.

Përshkrimi faktit i Pikës 3 mbetet i njëjtë siç është përcaktuar në aktgjykimin e shkallës së parë, kurse kualifikimi të saj ligjor bëhet Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në shkelje të nenit 328 paragrafit 2 të KPPK-së, në këtë, më 10 tetor 2005, në fshatin Xërxë, Komuna e Prizrenit, ai ka pasur në posedim armën.

13. Palët në ankesat e tyre kanë ngritur çështje tjera të cilat mund të ekzaminohen edhe sipas detyrës zyrtare, dhe në veçanti shkeljet e dispozitave të procedurës penale të paraparë me nenin 403 paragrafin 1 pikën 12, dhe shkeljen e ligjit penal.

Sa i përket pikave tjera të cilat kjo Gjykatë është e obliguar ti ekzaminoj sipas detyrës zyrtare, as në procedurën e shkallës së parë e as në aktgjykimin e kundërshtuar nuk janë gjetur shkelje tjera të procedurës penale dhe ligjit penal.

Çështjet e ngritura nga Ankuesit

II


14. Ankesa e Ruzhdi Gashit dhe Ethem Rugovës nga Prizreni si avokatët mbrojtës të të pandehurit Osman Zyberaj është paraqitur më 4 gusht 2008.

Aktgjykimi i shkallës së parë është ankimuar për shkak të:

- shkeljes esenciale të dispozitave të kodit të procedurës penale – neni 402, paragrafi 1, pika 1, lidhur me nenin 403, paragrafin 1, pikën 12 të KPPK-së;
- vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike – neni 402, paragrafi 1, pika 3, lidhur me nenin 405 të KPPK-së;
- shkeljes së ligjit penal – neni 402, paragrafi 1, pika 2, lidhur me nenin 404, pikën 1 të KPPK-së dhe
- vendimit lidhur me sanksionet penale – neni 402, paragrafi 1, pika 4, lidhur me nenin 406, paragrafin 1 të KPPK-së.

Avokati Mbrojtës propozon:

- të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar i lëshuar nga Gjykata e Qarkut në Prizren në mënyrë që të lirohet i akuzuari Osman Zyberaj nga akuzat për veprat penale nën pikën 1, 2 dhe 3 të dispozitivit,
- të shqiptojë një dënim më të butë për veprën penale nën pikën 4 të dispozitivit të aktgjyimit të ankimuar, ose
- të prish aktgjykimin dhe ta kthej lëndën për rigjykim, ose
- të shqiptojë një dënim më të butë.



Arsyet e ankesës së paraqitur në emër të të pandehurit janë si në vazhdim.

Shkeljet esenciale të procedurës penale.

15. Paaftësia e pretenduar e të pandehurit për ta përcjell gjykimin dhe ti kuptoj akuzat për shkak të sëmundjes fizike dhe psikologjike.

Ankesa pohon që gjatë shqyrtimit gjyqësor i pandehuri ka qenë nën mbikëqyrjen e doktorit i cili ka ndërmarr intervenime mjekësore dhe ka administruar barëra të ndryshme.

Prandaj, i pandehuri nuk ka qenë në gjendje ta përcjell gjykimin dhe ti kuptoj akuzat e ngritura kundër tij.

Prapë, sipas ankesës, momentalisht i pandehuri ndihet më mirë dhe vërteton që është në gjendje të ballafaqohet me drejtësinë.

Kjo pikë e ankesës është e pabazuar.

Vetë avokatit mbrojtës i kujtohet kontrolli dhe mbikëqyrja e vazhdueshme e ushtruar nga personeli mjekësor i caktuar nga Gjykata e parë, kujdesi dhe medikamentet e dedikuara për gjendjen shëndetësore të të pandehurit.

Ankesa nuk i ofron kësaj Gjykate ekspertizë mjekësore lidhur me paaftësinë e të pandehurit gjatë shqyrtimit gjyqësor e as për aftësinë e tij për momentin.

Gjykata e Shkallës së Parë (faqet 17 - 18) i rikujton kundërshtimet e ngritura nga i pandehuri dhe avokati mbrojtës lidhur me aftësinë fizike dhe mendore të Zyberajt, informatat klinike të marra nga Gjykata dhe mbikëqyrja mjekësore dhe kujdesi i ushtruar gjatë seancës në mënyrë që të minimizohet rreziku shëndetësor i shkaktuar nga pjesëmarrja e tij në gjykim.

Gjykata e parë ka qenë vazhdimisht e informuar që Zyberaj ka qenë “i aftë në aspektin mendor dhe i orientuar në të gjitha aspektet” dhe që përkundër gjendjes së tij të rëndë kardiake, “me kujdesin e duhur” ai do të jetë në gjendje të marrë pjesë në gjykim dhe ta ndihmojë avokatin në mbrojtjen e tij.

Gjyqtari i parë rikujton kujdesin e ndërmarrë: shtrati në dispozicion të të pandehurit në gjykatore, mbikëqyrje mjekësore të vazhdueshme, periudha të pushimit gjatë shqyrtimit.


Gjykatës së parë gjithashtu i kujtohet që, përkundër dobësisë së shfaqur gjatë shqyrtimit, “gjatë pushimeve ose herëve tjera jashtë gjykatore, ai dukej i gjallëruar, syçelë dhe ka biseduar me lehtësi me familjarët, miqtë dhe mbrojtjen”.

Kjo Gjykatë vëren që shumë dokumente mund të gjenden në shkresat e lëndës lidhur me gjendjen fizike dhe mendore të të pandehurit, vëmendja e vazhdueshme e kushtuar nga ana e gjyqtarit të parë në këtë çështje gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor.

Pjesëmarrja e Zyberajt në shqyrtim është përcjellë nga personeli mjekësor.

Shqyrtimi i parë është vonuar apo anuluar për shkak të pohimeve të tij për gjendje të paqëndrueshme shëndetësore.

Me kërkesë të avokatit mbrojtës, në mënyrë për ta ndihmuar kujdesin e nevojave shëndetësore të të pandehurit dhe pjesëmarrjes së tij në shqyrtim pa stresin e udhëtimit,



Gjykata i ka lejuar që së pari të transferohet nga Dubrava në Qendrën e Paraburgimit në Prizren.

Më vonë, me propozimin e Departamentit të Drejtësisë, PSSP-ja ka autorizuar ndryshimin e vendit të mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe disa shqyrtime janë mbajtur në Qendrën e Paraburgimit në Dubravë ku i pandehuri i ka pasur shërbimet mjekësore të vazhdueshme nga personeli mjekësor.

Monitorimi i vazhdueshëm i ofruar nga strukturat mjekësore të burgut ku Zyberaj mbahej kanë qenë të shoqëruara me një ekspertizë të posaçme fizike dhe mendore të kërkuar nga Gjykata e Qarkut më 26 shkurt 2008, në mënyrë që të përcaktohet aftësia e tij për ta përballuar gjykimin.

Të dy raportet ai fizik dhe psikiatrik (shih raportin e Dr. Petrit Ademaj, të datës 4 mars 2008) kanë konstatuar aftësinë e të pandehurit për të marrë pjesë në gjykim.

Ekspertiza psikiatrike, e nënshkruar nga dy psikiatra dhe një neurolog ka konstatuar që i pandehuri kishte vuajtur nga hipertensioni kronik, sulme ankthi dhe depresioni si pjesë e Çrregullimit të Stresit Post Traumatik.

Sidoqoftë atij nuk i ka humbur kontakti me rrethin dhe realitetin dhe ka qenë i aftë për gjykime të shëndosha.

Ai nuk është konstatuar të ketë qenë psikotik.

Gjendja mendore e të pandehurit i ka lejuar atij ti kuptoj akuzat, ta udhëzoj mbrojtjen e tij, të merr vendim të shëndoshë lidhur me pranimin, të kuptojë pasojat e pranimit të tij, të përcjell procedurat gjyqësore dhe ti sfidojë dëshmitarët, me fjalë tjera ta përballoj gjykimin.

Ekspertiza ka shtuar që “dozat e larta të neuroleptikëve (medikament qetësues) mund të kenë ndikim në funksionet e njohjes”.

Këto barëra të administruara te i pandehuri në rastin konkret nuk kanë rezultuar të kenë qenë doza të larta të neuroleptikëve siç është vërejtur nga Gjykata e parë sipas mendimit të psikiatrit të njëjtë të caktuar për ekspertizën (procesverbali i shqyrtimit të 6 marsit 2008).


Përfundimisht, nga procesverbali rezulton që gjyqtari i parë e ka përcjellë sjelljen e të pandehurit gjatë shqyrtimit, duke e vlerësuar drejtpërdrejtë pjesëmarrjen dhe komunikimin e tij me Gjykatën dhe avokatin e tij mbrojtës; ky vëzhgim i drejtpërdrejtë e ka mbështetur vendimin e Gjykatës së parë për të vazhduar.

Mund të përfundohet që gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk ka pasur shkelje të drejtave të të pandehurit në këtë pikëpamje.

Mund të shtohet, sa i përket fazës së tanishme, në shkresat e lëndës gjendet mendimi i Doktorit të Qendrës së Paraburgimit në Dubravë, Nexhip Shatrit, të datës 15 korrik 2009 duke vlerësuar që Osman Zyberaj “do të jetë në gjendje të marrë pjesë në një gjykim të shkurtër më 21 korrik 2009”.

I pandehuri ka qenë i pranishëm në seancën e mbajtur pranë kësaj Gjykate më 21 korrik 2009, pa ngritur asnjë çështje lidhur me gjendjen e tij të tanishme shëndetësore.

16. Ankesa pohon mungesën e përshkrimit në dispozitiv të mizorisë së pretenduar të krimin të vrasjes (Pika 1), mënyrës si është qëlluar viktima dhe armës nga e cila është qëlluar viktima. Vërejtje të ngjashme janë ngritur në lidhje me Pikën 2, e cila nuk



përmban karakteristikat themelore të veprës penale që akuzohet sa i përket gatishmërisë së veprës.

Pika në lidhje me mizorinë e pretenduar të krimit të vrasjes ka humbë rëndësinë e vet, pasi që kjo Gjykatë ka vendosë të përjashtojë rrethanat rënduese të përcaktuara me nenin 147 pikën 5 të KPPK-së për arsye faktike.

Kjo gjykatë konsideron pjesën e mbetur të kësaj pike si të ankesës si të pabazuar.

Sipas nenit 403 paragrafit 1 pikës 12 ka një shkelje esenciale të procedurës penale vetëm nëse dispozitivi është “ i pakuptueshëm apo në kundërshtim me vetveten”. Nenet 396 paragrafi 4 dhe 391 paragrafi 1 i KPPK-së bëjnë të qartë se dispozitivi duhet të përmbajë “të dhëna të nevojshme”: vepra për të cilën i pandehuri është shpallur fajtor, bashkë me faktet dhe rrethanat që tregojnë natyrën kriminale të veprës së kryer dhe faktet e rrethanat mbi të cilat varet zbatimi i dispozitave përkatëse të ligjit penal.

Përkundrazi, në pjesën e arsytimit të aktgjykimit “ gjykata do të shpallë qartë dhe duke i shterur të gjitha mundësitë se cilat fakte i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara, si dhe arsyet për këtë”.

Në këtë rast dispozitivi (Pikat 1 dhe 2) përmban indikacione të qarta të veprave penale për të cilat dy të pandehurit janë shpallë fajtorë për vrasjen e Hasan Rustemit dhe vrasjen në tentativë të Nezim Rustemit.

Në të dyja pikat është treguar roli i të dy të pandehurve si bashkëkryerës, veprimi i tyre thelbësor në hapjen e zjarrit ndaj dy viktimave, qëndrimi i tyre subjektiv në qëllimin e privimit të viktimave nga jeta.

Pika 3 e bën të qartë se secili i pandehur kishte në posedim armën me të cilën ai ka shtënë.


Deri tani dispozitivi duket të jetë plotësisht i kuptueshëm dhe në pajtim me vetveten, kurse shpjegime më të mira dhe më të sakta do të lexohen vetëm në pjesën e arsytimit.

17. Kundërthënia në mes dispozitivit, ku veprat penale nën Pikat 1 dhe 2 janë kualifikuar si të ishin kryer në bashkëpunim duke mos përmendur një plan specifik apo marrëveshje paraprake dhe pjesa e arsytimit të aktgjykimit, ku përmendet kjo marrëveshje paraprake.

Ky argument nuk është i bazuar për arsyet e njëjta të shpjeguara në pikën paraprake. Mjafton që dispozitivi tregon formën e përgjegjësisë së secilit të pandehur (në këtë rast në bashkëkryerje me një person tjetër), kurse është detyrë e pjesës së arsytimit të shpjegojë se çfarë kuptimi ka bashkëpunimi në këtë rast, planin paraprak dhe paramendimin apo përgatitjen e vetë momentit të faktit.

18. Kundërthënia e brendshme e pjesës së arsytimit të aktgjykimit të kundërshtuar sa i përket motivit të vrasjes: në një pjesë arsyeja e vrasjes është se Hasan Rustemi ishte dëshmitar i mbrojtur në gjykimin kundër një familjari të Osman Zyberajt, në pjesën tjetër arsyeja tregohet në faktin se Hasan Rustemi ishte kundërshtar i të pandehurit.

Ankesa e potencon rëndësinë e motivit të sjelljes sepse aktgjykimi i kundërshtuar ngarkon të akuzuarin me veprën penale të paraparë me nenin 147 pikën 8 të KPPK-së, se kjo është vrasje me qëllim të fshehjes së një vepre tjetër penale.



Kjo pikë e ankesës është e pabazuar.

Së pari duhet të shënohet se aktgjykimi i kundërshtuar nuk i zbaton dispozitat ligjore të nenit 147 paragrafit 1 pikës 8 për akuzat për të cilat janë dënuar dy të pandehurit.

Në dispozitiv qëllimi i fshehjes së krimi tjetër nuk është konsideruar si pjesë e krimi të ngarkuar të vrasjes dhe vrasjes në tentativë.

Vetëm pjesa e arsytimit (faqet 24-25) përmend pikën 8 të nenit 147 paragrafin 1 të KPPK-së, kjo është megjithatë një obiter dictum e cila nuk është përdorur për të përcaktuar përgjegjësinë e të pandehurve e as dënimin kundër tyre (faqet 27 - 28).

Për të treguar nenin 147 pikën 8 të KPPK-së në pjesa e arsytimit mund të konsiderohet si e panevojshme dhe nuk paraqet shkelje esenciale të procedurës penale.

Së dyti, pjesa e arsytimit paraqet dy motive të mundshme për veprat penale: rivaliteti në mes Hasan Rustemit dhe familjes Zyberaj dhe fakti se i pari ishte dëshmitar në një gjykim kundër disa anëtarëve të UÇK-së, në mesin e tyre edhe një i afërm i të pandehurit. Këto motive janë të paraqitura si “motivime të mundshme” të veprës penale, nuk janë medoemos të ndërkëmbyeshme me njëra tjetrën.

Përkundrazi cilësia e dëshmitarit në gjykimin kundër anëtarit të familjes Zyberaj mund të konsiderohet si pjesë e rivalitetit në mes viktimës dhe asaj familjeje.

Prandaj, nuk ka kundërtënie në arsyetim sa i përket motiveve të krimi.

19. Mungesa e arsyeve lidhur me këto fakte vendimtare:

nëse motivi i vrasjes ishte eliminimi i dëshmitarit të mbrojtur, a kishte njohuri Osman Zyberaj për këtë cilësi të viktimës dhe si e dinte ai këtë?

në këtë rast cila ishte arsyeja për të eliminuar Nezim Rustemin?

cili kryerës qëllon cilën palë të dëmtuar?

pasi që në vendngjarje janë gjetur gëzhojat që vijnë vetëm njërës armë, si është e mundur që të dy të akuzuarit kanë shtënë?

a kishte persona tjerë në afërsi dhe a ishin ata të rrezikuar?

Prej cilës pozitë ka shkrepur armën i akuzuari?

Kjo pjesë e ankesës është e pabazuar.

Siç shihet më lart, pjesa e arsytimit tregon rivalitetin në mes Hasan Rustemit dhe familjes Zyberaj dhe cilësinë e dëshmitarit të Hasan Rustemit si “motivim të mundshëm”.

Së pari, është vërtetuar me dëshminë e vëllait të tij Nezimit dhe gruas së të pandehurit Bukurije Zyberaj se Rustemi kishte punuar për Sekretariatit e Punëve të Brendshme të Serbisë.


Prandaj, këtë në veçanti e dinte mirë i pandehuri dhe familja e tij.

Osman Zyberaj ishte anëtar i UÇK-së.

Zyberaj dhe familja Rustemi vijnë nga i njëjti fshat Drenovci, Osmani dhe Nezimi kanë kryer bashkë në shkollën fillore.

Sipas Bukurije Zyberajt, Hasani ishte përgjegjës për një lloj të persekutimit ndaj familjes së Osmanit dhe të gjithë shqiptarëve në përgjithësi.

Kjo arsye mund të formojë motivin e veprave penale të akuzuara.



Së dyti, më 29 shtator 2005 në Gjykatën e Qarkut në Prizren filloi një gjykim kundër një shoku të afërm të të pandehurit (Bedri Zyberaj).

Veprat penale ishin lidhur me qendrën e paraburgimit që pretendohet se ishte udhëhequr nga anëtarët e UÇK-së në fshatin Dranovc në Zatriq, Komuna Rahovec gjatë muajve maj dhe gusht 1998.

Mes viktimave të mbajtura në atë qendër paraburgimi ishte edhe Murat Rustemi, vëllai i Hasanit dhe Nezimit.

Osman Zyberaj rezultoi të ketë qenë i pranishëm në publik gjatë në dëgjimin e parë (shih listën e pjesëmarrësve në dosjen e provave materiale).

Nezim Rustemi ka dëshmuar në atë gjykim. Ekzistimi i këtij gjykimi është vërtetuar këtu me dëshminë e Nezim Rustemit.

Osman Zyberaj qartazi ishte në pozitë për tu informuar rreth hollësive të këtij gjykimi për shkak të lidhjeve të tij familjare, vendore dhe ushtarake. Gjykata e Shkallës së Parë e demonstron këtë gjykim si motivim të mundshëm të krimeve dhe kjo hipotezë duket logjike. Nuk është motivimi i vetëm dhe nuk është në kundërshtim me rivalitetin mes dy familjeve apo Hasan Rustemit dhe shqiptarëve.

Sa i përket arsyeve për të eliminuar Nezim Rustemin. Gjykata e parë tregon qartë (faqe 24) se veprimi nuk ishte i drejtuar vetëm "për ti marrë jetën dy viktimave, por edhe të frikësojnë një fraksion të caktuar të shoqërisë, dhe për të rrenjosur një frikë të përgjithshme brenda atij fraksioni dhe në shoqëri në përgjithësi". Kjo paraqet një arsye të vlefshme për vrasjen në tentativë edhe të Nezim Rustemit, si pjesë e fraksionit të kundërt sikur vëllai i Hasanit.

Veç kësaj, mund të shtohet se Nezimi ishte i pranishëm në vrasjen e Hasanit, ai e njihte Osman Zyberajn, dhe prandaj ishte dëshmitar i rrezikshëm i krimit.

Aktgjykimi i kundërshtuar (faqe 7 -9 dhe 25 - 26) tregon qartë se të dy të pandehurit kishin një armë me të cilën të dytë kanë shtënë kundër Hasan Rustemit, siç është vërtetuar me dëshminë e Nezim Rustemit (seanca e dëgjimit më 6 mars 2008 faqet 11 dhe tutje).

Agresorët ishin dy deri tri metra larg viktimave, ata arritën prapa Hasanit dhe përpara Nezim Rustemit duke ardhur nga një kënd, prej anës së djathtë. Të shtënat ishin në mori dhe pasi goditi Hasanin, Zyberaj drejtoi armën e tij kah Nezimi dhe shkrepri prapë.


Në treg ishin të pranishëm 10 deri 20 njerëz, po ashtu kishte edhe vetura dhe njerëz mu në vendin e të shtënave, ku u shkaktua një trazim dhe rrezik i përgjithshëm.

Këto elemente japin përgjigje në pyetjen e mbrojtjes mbi faktet vendimtare.

Çështja lidhur me numrin e armëve dhe të gëzhgojave do të ekzaminohen në kapitullin që ka të bëjë me rikonstruktimin faktik.

20. Mungesa e analizës serioze të dëshmive të mbledhura, veçmas dhe në lidhshmëri me njëra tjetrën, mungesa e vlerësimit të besueshmërisë së dëshmive kundërthënëse në shkelje të dispozitave të neneve 387.2 dhe 396.7 të KPPPK-së.

Si shembuj të këtij lloji të shkeljeve ankesa shfaq mungesën e arsyetimit sa i përket motiveve të krimit kundër të dy personave Rustemi, motiveve të cilat duhet të jenë ndryshe dhe që nuk janë qartësuar nga gjyqtari i parë dhe mungesën e arsyetimit sa i



përket motiveve të krimeve nga i pandehuri Shala, i cili nuk i ka njohur dhe kurrë nuk kishte pasur punë me viktimat.

Kjo pikë nuk është e bazuar.

Aktgjykimi i kundërshtuar vlerëson dëshmitë e mbledhura edhe veçmas (faqet 6 – 17) si dhe në tërësi (faqet 18 – 27).

Motivet e sulmit kundër dy viktimave janë hetuar drejt siç shihet nga pika paraprake.

Ankesa në emër të Zyberajt shtron pyetje në disa pika lidhur me pozitën e të pandehurit tjetër, Shqyeri Shala.

Të gjitha ato do ta gjejnë përgjigjen në pjesën e përkushtuar këtij ankuesi.

21. Ankesa ngrit dyshime mbi lirshmërinë e identifikimit të bërë në gjykatore nga ana e dëshmitarit Nezim Rustemi në lidhje me të pandehurin Shqyeri Shala, që do të thotë se dëshmia ishte e papranueshme dhe dëshmitari i pabesueshëm.

Lejueshmëria dhe vlera dëshmuese e identifikimit të Shqyeri Shalës do të shqyrtohet në pjesën që ka të bëjë me ankesën e këtij të pandehuri.

Këtu mund të vërehet se për shkak të shkeljes së procedurës papranueshmëria e mundshme e një pjese të dëshmisë nuk ndikon automatikisht në pasigurinë e pjesës tjetër të saj.

Në këtë rast, gabimi i mundshëm në procedurë gjyqësore i bërë nga gjyqtari i parë në lidhje me identifikimin e Shalës nuk do të thotë se deklaratat tjera të dëshmitarëve lidhur me faktin dhe të pandehurin tjetër nuk janë të besueshme.

Arsyetimi i aktgjykimit të kundërshtuar bën të qartë se Nezim Rustemi njihnte Osman Zyberajn pasi që ata ishin nga i njëjti fshat.

Në këtë dëshmi Nezim Rustemi shpjegon se kishin shkuar në shkollën e njëjtë fillore me të pandehurin, prandaj e njihnin njëri tjetrin personalisht shumë mirë.


Që prej momentit të parë të hetimeve në polici Nazimi kishte deklaruar se Osman Zyberaj ishte njëri nga sulmuesit (shih dëshmitarin Luan Vuciterna) pa asnjë ndikim të mëhershëm të jashtëm dhe vazhdimisht e ka përsëritur këtë deri në shqyrtimin gjyqësor. Kështu që asnjë shkelje e procedurës penale nuk mund të shihet sa i përket identifikimit të Zyberajt prej dëshmitarëve.

Pasi që, siç do të shfaqet edhe në kapitullin e ardhshëm, kjo pikë e ankesës nuk qëndron sepse mbrojtja nuk ka mundur të demonstrojë vullnetin e Nezim Rustemit për të bërë shantazh ndaj Osman Zyberajt ose së paku gabimin e tij gjatë identifikimit të këtij të pandehuri.

22. Ankesa ngrit dyshime rreth pronësisë së veturës që është parë në vendin e krimit nga ana e Shqyeri Shalës.

Po ashtu kjo pikë do të shqyrtohet në pjesën që lidhet me ankesën në emër të Shqyeri Shalës.

Vërtetim i gabuar dhe jo i plotë.



23. Ankesa kundërshton aktgjykimin sa i përket vlerësimit të besueshmërisë së dëshmitarit Nezim Rustemi mbi të cilin bazohet i tërë aktgjykimi i kundërshtuar. Nezimi kishte arsye të forta për të akuzuar Osman Zyberajn në mënyrë të rreme. Ankesa pohon ekzistimin e dyshimit se vëllai i dy viktimave, pra Murat Rustemi ishte kidnapuar dhe likuiduar nga njësitet e UÇK-së të cilave i përkiste Osman Zyberaj. Në mes dy familjeve ekzistonte një rivalitet dhe anëtarët e familjes Rustemi vazhdimisht kërcënonin familjen Zyberaj. Ekzistimi i hakmarrjes në mes dy familjeve vë në dyshim kualifikimin ligjor të veprave penale të ngarkuara. Po ashtu në këtë rast ankesa përsëri shtron pyetjen se për çfarë arsye Shyqeri Shala duhej të merrte pjesë në këtë krim.

Kjo pikë është e pabazë.

Arsyet e treguara në ankesë nuk arsyetojnë dyshimin se dëshmia e Nezim Rustemit është e rrejshme.

Së pari, Osman Zyberaj nuk ishte një nga të pandehurit e gjyqimit për kidnapimin e Murat Rustemit.

Ai gjykim nuk caktoi ndonjë arsye që Nezim Rustemi të akuzojë rrejshëm vetëm Osman Zyberajn për vrasjen e Hasan Rustemit.

Nezimi tregoi emrin e Osmanit menjëherë pas të shtënave, ishte një deklaratë e sinqertë e dhënë pa ndonjë ndikim të jashtëm në dëshmitarin, për këtë arsye kjo deklaratë është e besueshme.

Ekzistimi i njëfarë persekutimi të familjes së Osman Zyberajt dhe në përgjithësi të gjithë shqiptarëve nga ana e Hasan Rustemit paraqet një arsye për hakmarrje kundër tij e jo për akuzë të rrejshme për vrasjen e bërë nga Nezimi kundër Osmanit.

Sa i përket kualifikimit ligjor të veprës së ngarkuar duhet të shënohet se neni 147 pika 11 e KPPK-së gjen zbatimin e vet edhe në rastin e hakmarrjes.

Pozita e Shalës do të shqyrtohet më pastaj.


24. Ankesa kundërshton logjikën e aktgjyqimit në pikën e armëve nga të cilat është shtënë në ditën kritike.

Pasi që vetëm tri gëzhoja janë gjetur në atë vend që i përkisnin armës së njëjtë gjyqtari i parë nuk arrin të shpjegojë pse ai e konsideroi si të saktë se është shtënë nga dy armë të ndryshme.

Ankesa pohon se Gjykata e Shkallës së Parë nuk ka pranuar propozimin e rikonstruktimit të vendit të krimit ose së paku të ekspertizës balistike mbi bazë të gabuar se ky veprim nuk mund të bëhet në fazën e gjyqimit.

Kërkesa origjinale e paraqitur nga mbrojtja e Osman Zyberajt më 1 prill 2008 shtroi edhe këto domosdoshmëri:

1. "të korrigjojë dështimet e mundshme lidhur me inspektimin e vendngjarjes, apo të eliminojë kundërthënien dhe deklaratat jologjike, që burojnë nga inspektimi joprofesional;
2. të vërtetojë mënyrën e kryerjes së veprës, nëse nuk ishin bërë hetimet tanimë në vendngjarje;



3. të vërtetojë saktësinë e deklaratave të mbledhura prej dëshmitarëve dhe palëve të dëmtuara, dhe përfundimisht të vlerësojë mbrojtjen apo deklaratat e të akuzuarit lidhur me rrethanat që kanë të bëjnë me vendin e saktë të krimit”.

Në kërkesën e tij origjinale mbrojtja theksoi se sipas dëshmisë së Nezim Rustemit në momentin e të shtënave në atë vend ishin të pranishme tri vetura: vetura e viktimave dhe dy kamionë, kurse sipas dëshmisë së Ismet Berishës, që ishte polici i parë që arriti në vendngjarje, nuk ishte gjetur asnjë kamion.

Dëshmitarët tjerë konfirmuan se në momentin e inspektimit policor nuk ishin gjetur kamionë në vendngjarje.

Në propozimin e vet origjinal mbrojtja kërkoi që në rikonstruktimin vendit të krimit të jenë të pranishëm Nazim Rustemi dhe dëshmitarët dhe dëshmitarët ekspertë që ishin dëgjuar në shqyrtim gjyqësor me qëllim të vërtetimit të fakteve dhe gjurmëve të tyre.

Kjo pikë e ankesës është e pabazuar.

Arsyetimi i gjyqtarit të parë (faqet 20 – 22) nuk përmend papranueshmërinë e hetimeve të reja në fazën e gjykimit.

Kjo shpreh domosdonë e arsyes së faktit dhe kohës dhe plotësueshmërinë konkrete të këtij lloji të propozimit.

Gjyqtari i parë refuzoi sepse kërkesa arriti vonë gjatë shqyrtimit gjyqësor, arriti pas dëshmisë së dëshmitarit kryesor, Nezim Rustemi, dhe pas largimit të tij nga Kosova. Palët shin shumë të vetëdijshëm për gjendjen e dëshmitarit të mbrojtur Nezim Rustemi, për faktin se ai jeton i mbrojtur jashtë Kosovës dhe për masat e jashtëzakonshme që janë marrë gjatë pjesëmarrjes së këtij dëshmitari në shqyrtimin gjyqësor.


Prania e tij në rikonstruktim ishte vlerësuar si e pamundur dhe e rrezikshme jashtë mase. Gjykata e parë e konsideroi si të pakuptimtë një rikonstruktim të ngjarjes pa praninë e viktimës.

Së fundi Gjykata e Shkallës së parë e vlerësoi si të padobishme veprimin që kërkoi mbrojtja sepse informatat që Këshilli shpresonte të merrte ishin në pjesën më të madhe tanimë në dosje (topografia dhe karakteristikat e përgjithshme të vendit të krimit) dhe elementet shtesë, siç janë prania apo mungesa e veturave të caktuara, u paraqitën si të ishin “me vlerë dëshmuuese të parëndësishme në përcaktimin se si ishin qëlluar viktimat”. Veç kësaj mbrojtja nuk kishte shpjeguar vlerën e dëshmimeve të mundshme me qëllim të kundërshtojë dëshmitë e prokurorisë.

Kjo Gjykatë ndan mendimin e gjyqtarit të parë.

Kërkesa origjinale e mbrojtjes nuk mundi të tregojë se çfarë kundërthëniesh do të mund të zbuloheshin përmes rikonstruktimit që u kërkua, dhe prandaj nuk mundi të demonstrojë domosdonë konkrete dhe leverdinë e këtij veprimi juridik. Mbrojtja kërkoi praninë e Nezim Rustemit në vendngjarje gjë e cila, siç u tha nga gjyqtari i parë, ishte shumë e rrezikshme për të mos thënë e pamundur.

Kërkesa e mbrojtjes nuk mori parasysh rezultatin e raportit të vendngjarjes (faqja 1295 e shkresës së lëndës) e cila thotë se, pa marrë parasysh gatishmërinë e intervenimit të policëve, pas arritjes së tyre ata “gjetën vendin e krimit të kontaminuar sepse qytetarët



kishin rrethuar vendin me thasë të specave, që ne mendojmë se ka ndihmuar fshirjen e gjurmëve të këmbëve, dhe kishin dërguar trupat në spital”. Kontaminimi i vendngjarjes dhe dërgimi i viktimave në spital nuk përjashtojnë largimin e veturave para arritjes së policisë, fakt që mund të shpjegojë dallimin në mes deklaratës së Nezim Rustemit dhe dëshmitarëve tjerë për këtë pikë specifike.

Siç u pa më lart ankesa e Osman Zyberajt insiston në pikën e dy armëve që pretendohet se kanë qëlluar viktimat gjersa në vendngjarje dhe nga trupi i Hasan Rustemit janë marrë gëzhojat dhe plumbat që vijnë vetëm prej një arme.

Sipas mbrojtjes kjo mund të arsyetojë rikonstruktimin e kërkuar të vendngjarjes, edhe pa praninë e Nezim Rustemit.

Kjo Gjykatë e konsideron këtë kërkesë si të pabazuar.

Numri dhe kualiteti i plagëve që i pësoi Hasan Rustemi japin dëshmi për tri apo katër armë zjarri të kenë shtënë kundër tij, dy prej tyre ishin ruajtur në trupin e tij (shih raportin e autopsisë dhe dëshminë e Dr. Ananda Samarasekera).

Këtyre tri apo katër të shtënave duhet ti shtojmë edhe të shtënat kundër viktimës së dytë Nezim Rustemi, i cili i lajmëroi tri plagë të ndryshme të shkaktuara nga armë zjarri. Edhe nëse pranohet hipoteza sipas së cilës Hasan Rustemi u qëllua vetëm me tre plumba dhe se njëri prej atyre plumbave doli nga trupi i tij dhe e qëlloi vëllanë e tij, duhet të përfundojmë se më së paku edhe dy qitje tjera ishin shkrepur kundër Nezim Rustemit. Kjo do të thotë se në atë rast së paku pesë plumba të ndryshëm plagosën dy viktimat. Fakti që në atë vend ishin gjetur vetëm tri gëzhoja mund të shpjegohet përmes kontaminimit të vendngjarjes të shkaktuar nga ndihma e parë e dhënë viktimave para arritjes së Policisë.

Me fjalë tjera gëzhojat e mbetura kanë mundur të shpërndareshin gjatë dhënies së ndihmës.


Një shpjegim tjetër i mundshëm është se sulmuesit kanë përdorë dy lloje të ndryshme të armëve, njëra që i qet jashtë dhe njëra që nuk i qet jashtë gëzhojat.

Në shqyrtim gjyqësor Nezim Rustemi deklaroi se nuk ishte i përqendruar në llojin e armëve dhe nuk ishte në gjendje të dijë nëse secili sulmues kishte pistoletë automatike apo revole (faqe 11). Duhet bërë peshime analoge për plumbat e ndryshëm nga at që janë gjetur në trupin e Hasan Rustemit, të cilat qartë janë zhdukur gjatë trajtimit të viktimave. Gjetja e gëzhojave në vendngjarje të shkrepura prej vetëm një arme nuk përjashton praninë e armës së dytë, nuk e zvogëlon logjikën e aktgjykimit të parë dhe nuk e bën të domosdoshme caktimin e procedurës së re për rikonstruktimin e veprave penale.

25. Ankesa ngrit dyshime rreth numrit të personave që gjuajtën dhe rreth pjesëmarrjes efektive të Shyqeri Shalës, duke nxjerrë në pah artikullin e gazetës “Lajm” që fliste për vetëm një kryerës.

Veç kësaj tregimi për një telefonatë të pranuar nga gazetari Qemal Krasniqi nuk mund të vërtetojë identitetin e sulmuesve.

Duhet të potencohet se artikulli i gazetës ishte shkruar me nguti nga dëshmitari në bazë të informatave të para, prandaj mund të përmbajë gabime që nuk mbështesin hipotezën se akuza kundër Shalës ishte “shpikur” më vonë.



Së dyti, gjyqtari i parë në mënyrë të qartë e kualifikoi dëshminë e Qemal Krasniqit për thirrjen telefonike që e pranoi në natën e 12 tetorit si "dëshmi rrethanore": pasi që ky dëshmitar nuk e njohu zërin e Osman Zyberajt ai nuk ka mundur të njohë atë dhe prandaj të japë dëshmi të drejtpërdrejtë të përgjegjësisë së tij dhe për të pandehurin e dytë. Gjyqtari i parë përdori dëshminë e Krasniqit si vërtetim të identifikimit të të pandehurve që bëri Nezim Rustemi (faqe 27). Kjo gjykatë konstaton se gazetari e qartësoi se ai nuk kishte mësuar emrat sulmuesve Osman Zyberaj dhe Shyqeri Shala prej asnjë burim tjetër para asaj thirrjeje telefonike.

Krasniqi menjëherë e ndreqi përmbajtjen e kësaj telefonate në një e-mail të dërguar Policisë dhe Gazetës së tij.

Kjo lejon që dëshmia e tij të kualifikohet si të vërtetë dhe të sinqertë: ai faktikisht pranoi një telefonatë nga një person që kishte thënë se ishte Osman Zyberaj dhe që kishte vlarë Hasan Rustemin në bashkëkryerje me Shyqeri Shalën.

Dëshmia rrethanore vërteton bindshëm identifikimin e Zyberajt nga ana e Nezim Rustemi, gjersa pozita e Shyqeri Shalës do të shqyrtohet më vonë.

Prapë mund të shtohet se të dyja artikulli i gazetës dhe telefonata japin arsye shtesë për vrasjen.

Lajm-i sjell në mend se Hasan Rustemi ishte një "punëtor aktiv i Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë" dhe dëshmitar në gjykimin kundër "grupit të Selim KRASNIQIT". Gjatë thirrjes në telefon ai njeri, i cili e cilësoi veten si Osman Zyberaj, shpjegoi se vrasja e Hasanit ishte bërë në emër të popullit për shkak të veprimeve të tij antikombëtare, ishte bërë në mesditë dhe nga persona të pamaskuar me qëllim të popullit të njoftohet se kush janë miqtë dhe kush janë armiqtë, duke ju premtuar "fatin e njëjtë të tradhtarëve" kundër atyre që përdhosin vlerat e luftës çlirimtare. Këto motive janë të njëjta me ato që identifikuar nga gjyqtari i parë si arsye të krimit.

26. Dënimi i Osman Zyberajt për veprën penale në lidhje me posedimin dhe përdorimin e armëve më 10 tetor 2005 në Xërxë bazohet në supozime të thjeshta.


Kjo pikë sikur edhe ato parapraket është e bazuar në rikonstruktimin e gabuar të gjendjes faktike të pretenduar. Rikonstruktimi faktik i bërë nga gjyqtari i parë është drejtësisht i bazuar në dëshmi e jo në supozime, prandaj kjo pikë e ankesës është e pabazuar.

Shkelja e ligjit penal

27. Në bazë të Pikës 1, ankesa në radhë të parë pretendon se aktgjykimi i kundërshtuar nuk ka dhënë asnjë arsye pse veprat në akuzë janë kryer në mënyrë mizore dhe të dhunshme (neni 147, pika 5).

Kjo pikë ka humbur rëndësinë e saj, pasi që gjykata ka vendosur që t'i përjashtojë rrethanat rënduese, të përcaktuara me nenin 147, pikën 5 të KPPK-së për arsyet faktike.

28. Së dyti ankesa pretendon se nuk është e besueshme që vrasja ka synuar parandalimin e Hasan Rustemit që të dëshmojë në lëndën e Selim Krasniqit (neni 147, pika 8), sepse Rustemi kishte refuzuar që të dëshmonte në atë gjykim për shkak të frikës.



Në të vërtetë, vëllai i tij Nezim Rustemi ka qenë dëshmitar në atë gjykim, por nuk është dëshmuar se Osman Zyberaj ka ditur këtë fakt ngase identiteti i atij dëshmitari në atë kohë ka qenë i panjohur.

Për më tepër, kjo ankesë thekson se sipas dëshmisë së Bukurije Zyberajt, i pandehuri kishte arsye për të vrarë Hasan Rustemin, të cilat arsye ishin tjera nga ato të dhëna gjatë dëshmisë në atë gjykim.

Arsyet e njëjta pohohen për kundërshtimin e Pikës 2.

Kjo gjykatë është e mendimit se gjyqtari i parë ka veçuar si duhet motivet e vrasjes dhe të vrasjes në tentativë, siç shihet më lart.

Në të vërtetë, aktgjykimi i kundërshtuar nuk përmban dënimin e dy të pandehurve për rrethanat rënduese të përcaktuara me nenin 147, pikën 8 të KPPK-së, d.m.th. kryerjen e vrasjes me qëllim të fshehjes së një vepre tjetër penale.

Kështu, të qenit e dy viktimave në cilësinë e dëshmitarëve në një gjykim tjetër nuk ka ndonjë rëndësi të veçantë në vendimin e gjyqtarit të parë. Aktgjykimi megjithatë e qartëson në faqen 25 motivin e krimeve, nga njëra anë në sjelljen e mëhershme të Hasan Rustemit ndaj Osman Zyberajt, familjes së tij dhe të gjithë shqiptarëve, duke sqaruar se sipas gruas së tij i pandehuri kishte arsye të forta që të frikohej dhe të kërkonte hakmarrje kundër viktimës.

Nga ana tjetër, dëshmia e Hasan Rustemit dhe e vëllait të tij Nezim Rustemit në rastin e Selim Krasniqit tregohet si një motiv tjetër i këtij krimi.

Konstatimi i kundërt i mbrojtjes nuk duket të jetë vendimtar, duke pasur parasysh se shqyrtimi gjyqësor kundër S. Krasniqit sapo kishte filluar dhe se Nezim Rustemi nuk kishte dhënë dëshminë e tij në gjykim, që edhe Hasan Rustemi ka mundur të ftohej që të dëshmonte dhe do të mund të pranonte përfundimisht rolin e tij

Osman Zyberaj e kishte përcjellë nga afër atë gjykim, siç rezulton nga lista e publikut që kishte marrë pjesë në seancat dëgjimore.


Madje edhe gazetarët si Qemal Krasniqi kanë qenë të informuar rreth dëshmisë së mundshme të Hasanit në atë gjykim

Të njëjtat arsye vlejné edhe për vrasjen në tentativë të Nezim Rustemit të akuzuar për pikën 2.

Siç shihet më lart Nezimi duhej të vritej ngase ishte vëllai i Hasan Rustemit, d.m.th. persekutues i familjes Zyberaj, sepse ishte dëshmitar në gjykimin kundër S. Krasniqit dhe Bedri Zyberajt dhe në fund ngase ishte dëshmitar i vrasjes së Hasanit.

29. Ankesa pretendon se pika 3 gabimisht i referohet veprimit penal të përcaktuar me nenin 328, paragrafët 1 dhe 2 të KPPK-së. Pasi që nuk është dëshmuar se i pandehuri kishte kryer veprat penale të vrasjes dhe të vrasjes në tentativë, ai është dashur që të akuzohet për armë vetëm për veprën penale të përcaktuar me par. 1 apo me veprën penale të përcaktuar me par. 2 të nenit 328.

Kjo pikë nuk është e bazuar. Siç është sqaruar më lart (shih pikën 1.12) kualifikimi i saktë ligjor i pikës 3 është sipas nenit 328, par. 2 të KPPK-së, për shkak të mbajtjes, kontrollit



dhe posedimit të paautorizuar të armës, përderisa përdorimi i saj bie brenda faktit që lidhet me vrasje të rëndë dhe vrasje në tentativë.

Dëshmitë e mbledhura (shih dëshminë e Nezim Rustemit) mbështesin në mënyrë efektive dënimin e të pandehurit për këtë veprë penale, sepse Osman Zyberaj ka qenë në posedim të armës për të cilën nuk ka pasur autorizim.

Prandaj është e qartë se sjellja e të pandehurve përbën vetëm një veprë penale dhe atë veprën që përcaktohet me paragrafin 2 të nenit 328 të KPPK-së.

Vendimi mbi dënimin

30. Ankesa konsideron dënimin e vendosur nga gjyqtari i parë si të padrejtë dhe të rreptë, me synim që t'i përmbajë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale duke vendosur që për të akuzuarin nuk ekziston asnjë mundësi e rehabilitimit.

Në këtë mënyrë, gjyqtari i parë ka harruar të kaluarën e dy të pandehurve në ushtri, lëndimet e rënda që Zyberaj dhe familja e tij si dhe bashkëfshatarët e tij kanë pësuar nga serbët, veprimtarinë e tyre të vlerësuar si afaristë dhe statusin familjar të të dy të pandehurve, mungesën e dënimeve të mëhershme.

Dënimi ka qenë shumë i rreptë sidomos nëse krahasohet me dënimet e dhëna në Hagë kundër "zotëve të luftës".

Po ashtu në rast të fajësisë së tyre, të dy të pandehurit do të konsideroheshin si heronj në komunitetin e tyre për shkak të rolit të të ndjerit Hasan Rustemi në dobi të serbëve gjatë luftës.


Kështu dënimi i ashpër nuk do ta arrinte rezultatin e parandalimit të njerëzve tjerë që mos ta ndjekin shembullin e të akuzuarit.

Gjyqtari i parë ka marrë parasysh qëllimet e dënimin, të përcaktuar me nenin 34 të KPPK-së, rrethanat rënduese (neni 147, par. 5 i KPPK-së), të cilat i tejkalojnë rrethanat lehtësuese, shkallën e përgjegjësisë penale, motivet e veprës, rrezikun e shkaktuar nga karakteri publik i kësaj vrasjeje politike, rëndesa e veprës penale dhe sjellja e të pandehurve, dhe ka vendosur që të shqiptojë burgim afatgjatë (25 vjet) për Pikën 1, burgim afatgjatë (25 vjet) për pikën 2, 6 vjet për pikën 3 dhe 3 vjet për pikën 4, dhe përfundimisht ka caktuar dënimin total prej 25 vjet burgim.

Kjo gjykatë në përgjithësi pajtohet me vlerësimin e bërë nga Gjykata e Qarkut, në veçanti sa i përket rëndesës së veprës penale.

Vrasja ka ndodhur në tetor 2005, gjashtë vjet pas përfundimit të konfliktit në Kosovë. Çfarëdo të ketë bërë Hasan Rustemi në njërin anë dhe Osman Zyberaj në anën tjetër gjatë këtij konflikti, kjo është dashur të konsiderohet si pjesë e të kaluarës. Në kohë të paqes, çdo pretendim mbi krime të kryera gjatë luftës paraprake duhet që t'i referohet gjyqësorit.

Vepra e hakmarrjes, siç shihet të jetë vepra e Zyberajt, nuk mund të jetë kurrë akt i drejtësisë. Siç dëshmohet nga telefonata e bërë nga Zyberaj tek Qemal Krasniqi, i pandehuri dëshironte t'i vazhdonte efektet e konfliktit edhe në kohën e tashme, duke i frikësuar pjesëtarët e palës kundërshtare me qëllim që t'i detyrojë të njëjtit t'i bashkëngjiten palës së tij.



Për këtë arsye, kriteret e zbatuara nga gjyqtari i parë duken të jenë të sakta. Rrethanat rënduese qartë dominojnë mbi ato lehtësuese të dhëna në ankesë. Kjo gjykatë ka vendosur që t'i bashkojë pikat 1 dhe 2 në një vepër penale të vetme të vrasjes së rëndë, në pajtim me nenin 147, pikën 11 të KPPK-së.


Prandaj, dënimi për këtë vepër penale është i vetëm dhe jo dy dënime siç ishte rasti me aktgjykimin e kundërshtuar. Kohëzgjatja e dënimit të shqiptuar nga gjyqtari i parë për pikën që ka të bëjë me vrasjen e rëndë nuk mund të konsiderohet shumë e rreptë, duke pasur parasysh rëndesën e vepra të shumta dhe kjo është afër minimumit të burgimit afatgjatë (njëzet e një vjet). Dënimet për dy veprat e tjera penale të mbajtjes në pronësi, kontroll dhe në posedim të armës, ashtu siç është shqiptuar nga gjyqtari i parë, po ashtu duket të jetë në rregull. Pika 3 lidhet me armë funksionale dhe shumë të rrezikshme, e cila është përdorur për të kryer vrasje dhe për tentativë të vrasjes së dytë, pika 4 lidhet me armën tjetër funksionale dhe të rrezikshme, e cila ishte e gatshme për t'u përdorur.

Një dënim më i ulët nuk do të kishte mundësi ta përmbante të pandehurin dhe të tjerët që të mos kryenin vepra të ngjashme edhe kundër "armiqve" të tjerë në të ardhmen. Dënimi i shqiptuar përmbush si nga karakteri ashtu edhe nga masa e marrë edhe qëllimin e rehabilitimit, duke pasur parasysh nevojën që i pandehuri ta kuptojë si duhet të jetohet në paqe me kundërshtarët e dikurshëm. Dënimi total duhet patjetër të mbetet burgim afatgjatë prej 25 vjetësh, në përputhje me nenin 71, par. 2, pikën 1 të KPPK-së.

Kërkesa e paraqitur nga i pandehuri Osman Zyberaj

31. Më 29 tetor 2008, mbrojtësi i Osman Zyberajt bashkëngjitur ankesës së tij ia ka dërguar kësaj gjykate edhe një letër të të pandehurit më 25 tetor 2008. Në këtë letër, i pandehuri pretendon se ka qenë në gjendje të rëndë shëndetësore, edhe fizike edhe psikike gjatë rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor dhe kjo gjendje nuk ia ka mundësuar që t'i përcjellë procedurat gjyqësore. Nga ajo kohë, gjendja iu ka përmirësuar. Ai kërkon që lënda të rigjykohet sepse gjatë shqyrtimit gjyqësor ai s'ka mundur të thotë asnjë fjalë dhe shumë të tjerë që kanë shumëçka për të thënë, as nuk janë ftuar bile. Zyberaj shton se "pranon se ka vrarë Hasan Rustemin (shëfën e shërbimit serb të inteligjencës) dhe ka plagosur të vëllanë e tij", duke shpjeguar se ka qenë i vetmi person i përfshirë në këtë rast. Gjatë seancës pranë kësaj gjykate, Osman Zyberaj ka përsëritur kërkesën e tij dhe ka pranuar fajësinë për vrasjen që akuzohet.

Siç shihet më lart (shih pikën I.7), pjesa e dytë e kësaj kërkesë paraqet pranimin e fajësisë dhe jo dëshmi të reja. Për këtë arsye, është vendosur që të mos mbahet shqyrtimi për pranimin e dëshmive të reja. Sa i përket pjesës së parë të kërkesës, që kërkon rigjykim, gjykata vëren si më poshtë: neni 424.1 i KPPK-së detyron gjykatën e shkallës së dytë që të anulojë aktgjykimin e kundërshtuar dhe ta kthejë lëndën për rigjykim në rast të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale apo për shkak të vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike. Kërkesa e të pandehurit bazohet kryesisht në gjendjen e tij të dyshimtë shëndetësore gjatë shqyrtimit gjyqësor. Në këtë pikë duhet që të vërtetohet ato çka është vënë re (shih pikën II.15): gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk ka pasur shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, sepse gjendja shëndetësore e të pandehurit është monitoruar në vazhdimësi dhe i pandehuri është konstatuar të jetë i aftë që të përballojë gjykimin.



Së dyti, kërkesa e të pandehurit lidhet me heshtjen e tij gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe ekzistimit të shumë personave të informuar, të cilët nuk janë ftuar. Në këtë kuptim, ajo i referohet vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Në këtë pikë, kërkesa për rigjykim, ashtu siç është e formuluar, është e përgjithësuar dhe për këtë arsye e papranueshme. Në fakt, nga njëra anë i pandehuri nuk e paraqet mbrojtjen e tij, duke dhënë hollësi faktike, kurse nga ana tjetër ai nuk tregon kush janë këta dëshmitarë të ri apo fakte të reja, që meritojnë të dëgjohen. Për këtë arsye, kërkesa për rigjykim e formuluar nga Osman Zyberaj duhet patjetër të refuzohet.

32. Duke i marrë të gjitha këto parasysh, gjykata e shkallës së dytë vendos që pjesërisht ta pranojë ankesën e paraqitur në emër të Osman Zyberajt lidhur me kualifikimin ligjor të pikave 1, 2 dhe 3 dhe ta refuzojë pjesën tjetër të ankesës si dhe po ashtu kërkesën e bërë personalisht nga i pandehuri.

III

33. Ankesa e z. Rexhep Hasanit nga Prizreni si mbrojtës i të pandehurit Shyqeri Shala është paraqitur më 11 gusht 2008. Aktgjykimi i shkallës së parë është kundërshtuar për shkak të:

- Shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurave gjyqësore,
- Vlerësimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike
- Shkeljes së ligjit penal dhe
- Aktvendimit mbi sanksionimin penal.


Mbrojtësi propozon:

- Ndryshimin e aktgjykimit dhe lirimin e të akuzuarit nga të gjitha veprat penale, ose
- Tërheqjen e aktgjykimit në pajtim me nenin 420, par. 1, pikën 3 të KPPPK-së dhe kthimin e lëndës në gjykatën e shkallës së parë.

Kjo gjykatë konsideron si të bazuar pikën e ankesës që lidhet me përcaktimin e gabuar të gjendjes faktike të bërë nga gjyqtari i parë për të pandehurin Shyqeri Shala. Në këtë rast krejt ajo çka kërkohet për përcaktimin e saktë është një vlerësim tjetër i fakteve tashmë të konstatuara dhe jo mbledhja e dëshmive të reja (neni 424, par. 4 i KPPPK-së). Ky vlerësim tjetër shpie në ndryshim dhe jo anulim të aktgjykimit (neni 420, par. 1, pika 4 dhe neni 426, par. 1 i KPPPK-së). Pranimi i kësaj pike e bën të domosdoshme lirimin e të pandehurit nga të gjitha akuzat ndërsa ekzaminimin e pikave të tjera të kësaj ankese e bën të panevojshëm (neni 396, par. 9).


Përcaktimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike

34. Në bazë të ankesës, gjykata e shkallës së parë nuk ka ofruar asnjë dëshmi të vetme rreth përfshirjes së Shyqeri Shalës në këto vepra penale. Identifikimi i viktimës është bërë dy vjet pas fakteve, pas një mori rastesh për t'u informuar rreth të akuzuarit në mënyrë të paligjishme. Raporti i policisë i datës 13 tetor 2005 rreth bisedës në mes të policit Xhelal



Muçaj dhe gazetarit Qemajl Krasniqi përkitazi me telefonatën të cilën ky i dyti kishte pranuar nga kryerësit e pohuar nuk ka përmendur fare Shyqeri Shalën. Nuk ka pasur dëshmi që Shala posedon armë zjarri: përkundrazi, eksperti i balistikës ka përmendur tri gëzhoja të gjetura në vendngjarje, të gjitha të shkrepura nga e njëjta armë dhe me karakteristika të njëjta me plumbat e gjetur në trupin e viktimës, gjë që qartë eliminon të pandehurin si pronar të çfarëdo arme. Gjyqtari i parë ka lëshuar të konstatojë se Shyqeri Shala nuk kishte kurrfarë motivi për ta kryer veprat e ngarkuara penale dhe gjithashtu nuk ka marrë parasysh alibinë e Shalës, të dhënë nga dëshmitarët Arianit Jelliqi, Shani Kryeziu dhe Xhelal Thaqi, alibi e cila ia bën të pamundur praninë e tij në vendngjarje në momentin kritik.

Gjykata e shkallës së parë nuk pajtohet me vlerësimin e gjyqtarit të parë dhe këtë pikë të ankesës e konsideron të bazuar. Së pari, duhet të theksohet se dyshime të arsyeshme ekzistojnë lidhur me identifikimin e qitësit të dytë si Shyqeri Shala, nga ana e palës së dëmtuar dhe dëshmitarit okular Nezim Rustemi. Duhet të vërejmë se ekzistojnë dallime në mes të identifikimit nga ky dëshmitar të këtyre dy të pandehurve. Nezim Rustemi menjëherë pas incidentit i deklaroi policit (dëshmitari Luan Vuçitërna) se e ka njohur njërin nga qitësit si Osman Zyberaj. Deklarata e njëjtë është bërë nga Rustemi në polici gjatë intervistës së tij të parë të datës 11 tetor 2005 në spitalin e Prishtinës. Me atë rast, ai ka sqaruar se e njeh shumë mirë Zyberajn, bashkëvendësin e tij. Rustemi përsëriti se kishte njohur qitësin e parë Zyberaj, edhe para policisë (27 tetor 2005) edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, ku dëshmitari sqaroi se e njohte të pandehurin sepse janë nga i njëjti fshat dhe kishin shkuar në fillore në të njëjtën shkollë. Në deklaratën e tij të parë të datës 11 tetor 2005, Rustemi dha përshkrimin e të pandehurit (qitësit) të dytë si një burrë rreth 35 vjeçar, i shkurtër, zeshkan, me një mjekër të shkurtër dhe me një xhakëtë të zezë, por duke thënë se nuk ishte i sigurt nëse do të ishte në gjendje për ta identifikuar atë. Gjatë intervistës së tij të dytë para policisë më 27 tetor, Rustemi e ka përshkruar qitësin e dytë dhe ka shtuar se anëtarët e familjes së tij i kishin thënë se i dyshuari i dytë ishte Shyqeri Shala (faqe 000249). Ai ka sqaruar se nuk e njeh Shalën dhe pas këtyre deklaratave iu kanë treguar një varg fotosh, në mesin e të cilave ishte edhe fotoja e këtij të pandehuri, por Rustemi nuk ka qenë në gjendje që ta njohë të pandehurin. Herën e tretë, Rustemi është intervistuar nga policia më 8 korrik 2007, por kësaj radhe ai ka veçuar foton nr. 4 në vargun e fotove, pra foton e Shyqeri Shalës, edhe pse duke thënë se megjithatë nuk ishte i sigurt përmes fotografisë. Vetëm gjatë shqyrtimit gjyqësor ai ishte i sigurt në identifikimin e të pandehurit Shala. Ky identifikim megjithatë duket të jetë i dyshimtë. Nezim Rustemi filloi deklaratën e tij në gjykatë me fjalinë “po, unë jam pala e dëmtuar. Vëllai im është vrarë nga Osman Zyberaj dhe Shyqeri Shala.” Më vonë, pas veçimit të Zyberajt, Rustemit i është kërkuar që të shikojë nëpër gjykatore dhe të shohë nëse do të mund ta identifikonte ndonjë person që ka të bëjë me incidentin e hapjes së zjarrit. Rustemi me atë rast bëri me gisht kah Shyqeri Shala. Mbrojtësi vërejtë se në çastin e identifikimit nuk kishte publik të pranishëm në gjykatore dhe në të njëjtin rresht me të akuzuarin ishin të ulur vetëm tre avokatë mbrojtës. Prokurori nënvizoi praninë e nëntë personave të tjerë në gjykatore, prej të cilëve së paku katër nuk njiheshin qartë se ishin punëtorë të sigurimit. Kjo pikë ka një rëndësi tepër të madhe. Për dallim nga identifikimi i Zyberajt, i cili ndodhi qysh në momentin e parë, sepse Rustemi e njeh atë për shumë vite me radhë, identifikimi i Shalës kishte një karakter “progresiv”. Së pari, ai nuk e



njohu fare, më vonë dikush nga familjarët e tij ia tregoi emrin e agresorit të tij, por edhe pas kësaj ai nuk e njohu fotografinë e Shalës. Vetëm herën e tretë, gati dy vjet pas këtij incidenti, ai njohu fotografinë e tij, megjithatë pa qenë i sigurt. Në fund, Rustemi kishte arritur në shqyrtimin gjyqësor, duke ditur tashmë që edhe Zyberaj edhe Shala ishin agresorët dhe arriti ta njohë personalisht Shalën në një situatë shumë të veçantë, në një gjykatore të zbrazur, kur i pandehuri ishte i ulur pranë avokatëve të vet mbrojtës. Të gjitha këto sjellin tek dyshimi se Rustemi ka mundur të vuajë, përmes sugjestionëve të medieve apo familjes së tij, ndikimeve nga jashtë në kujtesën e tij dhe aftësisë për ta njohur agresorin e dytë. Ai mbase ka arritur ta bind vetveten gjithnjë e më tepër lidhur me identifikimin e Shalës si njërit nga kryerësit. Duket domethënëse fjalia e tij e parë para se ta shohë dhe ta identifikojë të pandehurin me një siguri të plotë. Një gjë e tillë krijon dyshim të arsyeshëm lidhur me këtë lloj identifikimi. Së dyti, Shala në kohën kritike kishte një veturë të së njëjtës markë (Opel Vectra) me ngjyrë të ngjashme (të ashtuquajtur burgundi), nëse jo krejt të njëjtë me veturën që është shfrytëzuar nga agresorët për ta bllokuar njërën nga viktimat dhe më vonë për të ikur nga vendi i krimit. Vetura e Shalës më kurrë nuk është gjetur nga policia. Ky element përbën vetëm dëshmi rrethanore, ngase nuk ka shenja karakteristike (numri i targave, shenja në karroceri, diçka të veçantë në brendinë e veturës), të cilat mund të shpijnë në identifikimin e kësaj veture si veturë që i ka takuar të pandehurit e jo vetëm si veturë e ngjashme.

Së treti, nga dokumentet e siguruara gjatë hetimeve rezulton se Osman Zyberaj dhe Shyqeri Shala kanë pasur këto biseda telefonike ndërmjet vete:


Zyberaj thërret Shalën në orën 16:10:52, kohëzgjatja e bisedës 42 sekonda,

Shala thërret Zyberajn në orën 16:17:52, kohëzgjatja 14 sekonda,

Zyberaj thërret Shalën në orën 16:19:05, kohëzgjatja 17 sekonda,

Këto thirrje paraqesin një tjetër dëshmi rrethanore, ngase kanë ndodhur pak minuta para të shtënave, kur Nezim Rustemi kishte parë Zyberajn duke përdorur telefonin dy apo tri herë. Duke pasur parasysh se Zyberaj në ato pak minuta nga ato thirrje do të tentonte t'i vriste dy persona, të cilët tashmë i kishte parë në treg, është shumë vështirë të besohet se ai po i bënte disa telefonata për t'i shqyrtuar ca tema të pakuptimta, siç fjala bie një borxh në vlerë prej 80 eurosh.

Nga ana tjetër, duhet të merret parasysh megjithatë se përmbajtja e këtyre telefonatave nuk dihet dhe nuk ka mundësi që të sigurohemi se Zyberaj dhe Shala flisnin për një vrasje. Për më tepër, nuk dihet ku kanë qenë dy telefonat në momentin e thirrjeve. Dokumentet në shkresa të lëndës nuk tregojnë ku kanë qenë këta telefona. Kjo gjë e bën të pamundshme refuzimin e mbrojtjes së Shalës, i cili pohon se kishte qenë afër Gjakovës kur kishte provuar të kontaktonte Zyberajn me telefon. Dyshimi i tretë rrjedh nga fakti se gjatë po këtyre minutave, kur Zyberaj dhe Shala po i telefononin njëri tjetrit, Zyberaj thirr nga telefoni i vet një numër tjetër (044-200-629 në orën 16:13:26, në kohëzgjatje prej 43 sekondash). Në ato pak minuta menjëherë para hapjes së zjarrit Zyberaj pranon në telefon të vet dy thirrje nga numri 044-315-667 (në orën 16:25:35, në kohëzgjatje 20 sekonda dhe në orën 16:26:19, në kohëzgjatje prej 46 sekondash) dhe po ashtu thirr numrin 044-504-031 (në orën 16:30:47, në kohëzgjatje prej 26 sekondash) si dhe numrin 044-200-629 (në orën 16:33:52, në kohëzgjatje prej 8 sekondash). Pa asnjë informatë tjetër, nuk është korrekte t'i atribuohet vlerë dëshmuese vetëm telefonatave në mes të Zyberajt dhe Shalës.



ndërsa jo edhe telefonatave të tjera që janë kryer në të njëjtën kohë. Njëkohësisht, megjithatë nuk mund të përjashtohet që telefonatat, të cilat kanë qenë të rëndësishme lidhur me vrasjen kanë qenë vetëm ato të zhvilluara ndërmjet telefonit të Zyberajt dhe të telefonave të personave të tjerë, pra jo të Shalës. Dëshmitë e marra nga këto tri telefonata në mes të dy të pandehurve paraqesin dëshmi rrethanore, të cilat mund t'i vërtetojnë dëshmitë e tjera por të cilat, nëse shqyrtohen të vetme, nuk mund të dëshmojnë përgjegjësinë e Shalës.

Së katërti, vërehet përtej vlerës së dëshmime rrethanore të telefonatës së pranuar nga gazetari Qemal Krasniqi dy ditë pas qitjes me armë. Edhe pse rrëfimi i bërë nga Krasniqi rreth përmbajtjes së telefonatës është i besueshëm¹, vetëm ky element nuk mjafton për ta provuar përgjegjësinë e Shalës.


Së pesti, dëshmitarët e mbrojtjes kanë konfirmuar praninë e Shalës në Xërxë, afër tregut të gjelbër gjatë periudhës në mes të orës 3 dhe 4 pasdite. Po ashtu, Shala ka pranuar se ka qenë në atë fshat dhe atë pak minuta para qitjes me armë. Xhelal Thaqi, megjithatë ka deklaruar se e kishte parë Shalën duke ikur kah Gjakova në restorantin e tij, ndërsa vetë i pandehuri ka theksuar se kishte ikur nga Gjakova më vonë në Shqipëri.

Po ashtu, ky element përfaqëson dëshmi rrethanore, ngase tregon afërsinë e të pandehurit si nga aspekti hapësinor ashtu edhe ai kohor me të shtënat, pa qenë në gjendje që të tregojë me siguri se ai ka qenë aty pikërisht në çastin e vrasjes. Materiali i sipërpërmendur formësohet nga një dëshmi e drejtpërdrejtë (dëshmia e Nezim Rustemit) dhe nga katër dëshmi rrethanore. Vetëm e para ka mundësi teorike që ta mbështesë aktgjykimin dënues, sepse lidhet drejtpërdrejt me krimin në pikën që tregon Shalën si një nga kryerësit e vrasjes.

Siç është thënë më lart, kjo dëshmi e drejtpërdrejtë nuk është plotësisht bindëse dhe mundëson dyshime të arsyeshme rreth identifikimit të vërtetë të këtij të pandehuri nga ana e dëshmitarit. Të gjitha dëshmitë tjera nuk kanë mundësi, të vetme që të mbështesin aktgjykimin dënues, ngase secili nga ta nuk është shterues dhe mundëson sqarime alternative të kundërta me qëndrimin e Prokurorit. Madje edhe të gjitha këto dëshmi nuk duken të jenë të mjaftueshme për eliminimin e dyshimeve të bazuara që po diskutohen. Kjo ngase asnjë nga këto dëshmi nuk plotëson mungesën e sigurisë, të paraqitur me dëshmi të tjera. Me fjalë të tjera, shtesa e të gjitha këtyre elementeve nuk plotëson boshllëqet e secilës prej tyre.

Edhe pse vërejtjet e tjera të ngritura nga ankesa (siç është numri i armëve nga të cilat është shkrepur në ditën kritike dhe mungesa e pohuar e arsyes për të cilën Shala do të

¹ Lidhur me kundërshtimin e ngritur në ankesë që ka të bëjë me numrin e personave të përmendur gjatë kësaj telefonate, duhet të vërejmë se e-maili origjinal i shkruar nga Qemal Krasniqi pak kohë pas pranimit të kësaj telefonate përmban edhe emrin e Osman Zyberajt edhe atë të Shyqëri Shalës. Ky e-mail ka qenë i menjëhershëm dhe prandaj duhet të konsiderohet në këtë fazë si më i besueshëm sesa raporti i shkruar ditën e nesërme nga Xhelal Muçaj pas një bisede të shkurtër me Krasniqin. Krasniqi gjithnjë ka thënë se kishte dëgjuar për këta dy emra dhe një gjë e tillë është konfirmuar edhe nga Xhelal Muçaj gjatë shqyrtimit gjyqësor (seanca e dëgjimit e datës 11 mars 2008, faqe 36).



tentonte t'i privonte nga jeta viktimat) nuk janë bindëse, konsideratat e lartpërmendura nuk mundësojnë arritjen e aktgjykimit në dënues përtej dyshimeve të bazuara kundër Shyqeri Shalës.

Pasi që pjesëmarrja e tij në veprat e ngarkuara penale nuk është e sigurt, Shyqeri Shala duhet patjetër që të lirohet nga të gjitha akuzat.

V

Aktgjykimi i shkallës së parë ishte ndryshuar pjesërisht në kualifikimin juridik të tri Pikave që kanë të bëjnë me sjelljen e Osman Zyberajt dhe me lirimin e Shyqeri Shalës.

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë në pjesët tjera vërtetohet. Ndryshimi i pjesës së aktgjykimit të shkallës së parë rezulton në bartjen e shpenzimeve të procedurës në shkallën e dytë nga ana e Osman Zyberajt.

Me një aktvendim të veçantë do të vendoset lidhur me masën e paraburgimit për secilin të pandehur veç e veç, sipas nenit 426 dhe 393 të KPPK-së.

Sot më 21 korrik 2009

Ap.-Kz Nr. 481/2008

Përgatitur në gjuhën angleze si gjuhë të autorizuar

Kryetari ndërkombëtar i kolegjit
Emilio Gatti


Procesmbajtësja ndërkombëtare
Annette Andersen

Gjyqtarja ndërkombëtare
Maria Giuliana Civinini

Gjyqtari ndërkombëtar
Guy Van Craen

Gjyqtari vendor kosovar
Salih Mekaj

Gjyqtari vendor kosovar
Avdi Dinaj



Republika e Kosovës  Republika Kosovo
SANTËRINË E KOPJËS E VËRTETON
ТАЧНОСТ ОТПРАВКА ПОТВРЂУЈЕ

Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik

Këshillë juridike

Kundër këtij Aktgjykimi lejohet ankesa (neni 430 i KPPK-së), e paraqitur me shkrim në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda 15 ditësh nga dita e dërgimit të kopjes së këtij aktgjykimi.